



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-82168/25 dt.11.06.2025 (*sipas e-Leja, LNI-00413*), në emër të aplikueses/pronarës Hysnije Muja nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtimin, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore - shtëpisë familjare me etazhitet P+1, në kuadër të bllokut urban “B-04”, të tërësisë urbane “B”, të “Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024”, në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914059-02535-0 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 22.07.2025 deri më 26.07.2025, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net.

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Shtëpi individuale me etazhitet – P+1
b. Vija rregulluese	Sipas Planit Rregullues
c. Vija ndërtimore c1. Ruga Publike c2. Anët – djathtas (AD) c3. Anët – majtas (AM) c4. Pasmë	5.00 m` 6.30 m` A.D – 3.00 m`, A.M – 1.08 m`, P – 5.25 m`,
c. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	6.00m`/5.00 m`
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	AM - Kthina primare min 0.5 H AD - Kthina sekondare min 0.2 H Më marrëveshje me fqin, deri në bashkim të plotë
e. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP = 30 % Të propozuar; 120.00 m², ose 30.00 %
f. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ = 50 %
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN = 0.80, Të propozuar; 258.70 m², ose 64.68 %
h. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 % Të propozuar; 0.00 m², ose 0.00 %
i. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	1
j. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Po
l. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit: